



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

UNIVERSITETI "FEHMI AGANI" UNIVERSITY
GJAKOVË

Pranuar	10/09/2025	vit	
N. org.	Numer	Sasia	Vlera
01	1785	2	



Ref.: 1046/25, Datë 05.09.2025

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ. nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë), nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 (GZ. nr. 14/9 shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031(GZ.nr.20/12 qershor 2016), Rregullores (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në nivelin Bachelor dhe Master, Rregullores (AKA) nr. 02/2025 për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 141-të, të mbajtur më 21.08.2025, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 - *Infomatikë Inxhinierike, BSc 180 ECTS, me kuotën 30 studente për vit akademik.*
- II. Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti "Fehmi Agani" në Gjakovë, të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim, vetëm nga KShC.
- IV. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Universiteti "Fehmi Agani" në Gjakovë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Infomatikë Inxhinierike, BSc 180 ECTS.	Drilon Bunjaku Ilmi Hoxha Agon Kokaj,

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin "Fehmi Agani" në Gjakovë.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; Infomatikë Inxhinierike, BSc 180 ECTS, vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit është organizuar më datë 05.02.2025 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit,
- Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit,
- Pjesërisht një (1) fushë e standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 141-të, të mbajtur më datë 21.08.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.


Prof. Assoc. Dr. Hasnija Hazi

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë